

TERMAT E REFERENCËS

STAFI MBËSHTETËS KOMUNAL – KONSULENTËT (Për ndërlidhjen e qytetarëve me adresa)

1. Hyrje

Në kuadër të projektit të Bankës Botërore, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka planifikuar edhe projektin për kompletimin e Sistemit të Adresave. Një nga aktivitetet e kompletimit të Sistemit të Adresave është ndërlidhja e qytetarit me një adresë zyrtare.

Me qëllim të gjetjes së metodologjisë adekuate të procesit të ndërlidhjes, GIZ-i gjerman ka mbështetur pilot projektin për ndërlidhjen e qytetarëve me adresa në dy komuna, Istog dhe Mitrovicë Jugore. Rezultatet e pilot projektit nuk kanë qenë të kënaqshme duke marrë parasysh se jo të gjitha adresat janë vizituar dhe një numër i vogël i qytetarëve janë pajisur me një adresë zyrtare. Në komunën e Istogut, numri i qytetarëve është më i lartë, ku përveç problemeve operacionale, kishte tabela me emrat e rrugëve dhe numrat e adresave. Megjithatë, në komunën e Mitrovicës së Jugut, numri i qytetarëve që janë pajisur me adresë ka qenë shumë i vogël, ku përveç problemeve operacionale, kanë munguar edhe tabelat me numrat e adresave.

Duke marrë parasysh rezultatet e pilot projektit dhe fondet në dispozicion për këtë proces, është vendosur që ndërlidhja e qytetarit me adresën do të realizohet përmes metodologjisë së angazhimit dhe kontraktimit të stafit prej 55 personave për një periudhë kohore prej 12 muajve nga AKK-ja dhe vendosjes së tyre në komuna në zyrat lokale të gjendjes civile, me qëllim që ARC-ja të kushtëzojë shërbimet për qytetarët, ku qytetarët, para kryerjes së shërbimeve, janë të detyruar të deklarojnë adresën tek stafi i angazhuar nga AKK-ja, pastaj stafi regjistron adresën në modulën e zhvilluar nga AKK-ja për gjenerimin e Certifikatës së Adresës. Moduli për gjenerimin e Certifikatës së Adresës do të jetë në dispozicion të ARC-së. Më pas, nga ky modul, të dhënat e adresave do të përditësohen në Sistemin e Gjendjes Civile. Ky proces është planifikuar të zgjasë të paktën 12 muaj, dhe do të mbështetet nga një fushatë e madhe e informimit publik. Ky proces është planifikuar të mbështetet me një shërbim në platformën E-Kosova, ku qytetarët mund të deklarojnë adresën e tyre zyrtare online pa pasur nevojë të paraqiten fizikisht në zyrat e gjendjes civile. Së pari, pjesa tekstuale e ARIS-it integrohet në platformën E-Kosova, dhe pastaj pjesa grafike e ARIS-it integrohet përmes shërbimeve të internetit.

Agjencia Kadastrale e Kosovës do të rekrutojë dhe paguajë gjithsej 55 konsulentë për të ngritur kapacitetet e komunave për të kryer këtë punë.

Konsulentët shpërndahen nëpër komuna sipas tabelës së mëposhtme, për të punuar në një nga komunat e listuara për një periudhë 12 mujore. Kandidatët duhet të cekin komunën ose komunat (deri në tri) për të cilat aplikojnë.

Gjendja aktuale:

Projekti i krijimit të Sistemit të Adresave kishte filluar në vitin 2010 dhe vazhdon të zbatohet edhe tani.

Aktivitetet e realizuara gjatë viteve 2010-2024 janë:

- Përgatitja e bazës ligjore (Ligji për Sistemin e Adresave, pesë Udhëzime Administrative dhe Manuali i Adresave),
- Ngritja e kapaciteteve në nivel komunal dhe qendror,
- Zhvillimi dhe instalimi i një Regjistri modern të Adresave të bazuara në ueb (ARIS) në AKK,
- Mbledhja e të dhënave dhe digjitalizimi i informacionit për Zonat e Qarkullimit Publik (ZQP), rrugët, sheshet, parqet, bulevardet, etj.
- Mbledhja e informacionit në lidhje me hyrjet e ndërtesave në terren dhe regjistrimi i numrave të adresave përkatëse në ARIS (rreth 450,000 hyrje)
- Emërtimi i rrugëve në 33 komuna,
- Sinjalizimi me tabela emërtuese në 31 komuna,
- Sinjalizim me tabela me numra të hyrjeve në 12 komuna,
- Përditësimi i segmenteve rrugore dhe numrave të adresave;
- Prodhimi dhe vendosja e tabelave me emrat e rrugëve dhe tabelave me numra e adresave në komunat e mbetura;
- Ndarja e të dhënave të adresave në 16 institucione vendore dhe ndërkombëtare, si TomTom dhe OpenStreetMap.

2. Aktivitetet për kompletimin e sistemit të adresave për Kosovën

Një proces shumë i rëndësishëm për Sistemin e Adresave është ndërlidhja e Regjistrit Civil me Regjistrin e Adresave, nëpërmjet pajisjes së qytetarëve me adresa zyrtare. Zyrat vendore të gjendjes civile dhe departamentet komunale për planifikim urban do të jenë akterët kryesorë përgjegjës për planifikimin dhe implementimin e projektit për kompletimin e ndërlidhjes së gjendjes civile me regjistrin e adresave.

Aktiviteti i ndërlidhjes do të zhvillohet në 34 komuna, duke përjashtuar 4 komunat veriore.

Procesi i ndërlidhjes përbëhet nga dy komponentë kryesorë:

I. Regjistrimi i qytetarëve dhe adresave të tyre në modulën e Certifikatës së Adresës.

Të dhënat duhet të regjistrohen në modulën e certifikatës në bazë të kërkesës së qytetarëve. Qytetarët do të kërkojnë të regjistrojnë adresën e tyre me numrin e letërnjoftimit, pastaj të caktojnë adresën zyrtare në ARIS.

II. Verifikimi i adresës në terren nëse qytetari nuk mund ta identifikojë adresën në kompjuter (hartë)

Nëse qytetari nuk mund ta identifikojë adresën në kompjuter (hartë) duhet të vizitohet në terren për të identifikuar adresën e qytetarit.

III. Dorëzimi i letrave informuese për adresat në terren për qytetarët

Për të përshpejtuar dhe lehtësuar procesin e ndërlidhjes së qytetarëve me adresat dhe për të informuar qytetarët për adresën zyrtare do të nevojitet dërgimi i letrave informuese të adresave për qytetarët në terren.

3. Rekrutimi i stafit ndihmës komunal – Konsulentëve

Konsulentët do të punojnë kryesisht në dy aktivitetet e përmendura më sipër, por gjithashtu mund të caktohen në aktivitete të tjera që ndërlidhen me adresat. Puna e konsulentëve përshkruhet në detaje më tej në pikën 3.2. më poshtë.

3.1 Shpërndarja e konsulentëve nëpër komuna

Konsulentët shpërndahen nëpër komuna sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Rajoni	Komuna	Stafi mbështetës komunal për përditësimin e të dhënave të adresave
1	Prishtinë	Prishtinë	4
2		Podujevë	2
3		Lipjan	2
4		Glllogoc	1
5		Fushë Kosovë	2
6		Novobërdë	1
7		Obiliq	1
8		Graçanicë	1
9	Mitrovicë	Mitrovicë	3
10		Vushtrri	2
11		Skenderaj	2
12	Pejë	Pejë	3
13		Istog	1
14		Klinë	1

15	Gjakovë	Gjakovë	3
16		Deçan	1
17		Rahovec	1
18		Junik	1
19	Prizren	Prizren	3
20		Suharekë	2
21		Dragash	1
22		Malishevë	1
23		Mamushë	1
24	Ferizaj	Ferizaj	3
25		Kaçanik	1
26		Shtime	1
27		Shtërpçë	1
28		Hani i Elezit	1
29	Gjilan	Gjilan	3
30		Viti	1
31		Kamenicë	1
32		Ranillugë	1
33		Kllokot	1
34		Partesh	1
TOTALI			55

Kandidatët që aplikojnë për punë si konsulentë duhet të cekin komunën e tyre të preferuar për kryerjen e punës së tyre. Kandidatët mund të cekin deri në tri komuna sipas renditjes së prioriteteve.

3.2. Detyrat specifike të stafit mbështetës komunal – konsulentëve janë:

- Njohuri për Ligjin dhe Udhëzimet Administrative dhe Manualin për Sistemin e Adresave dhe procedurat e gjendjes civile;
- Njohja e ARIS-it (moduli i certifikatës së adresës);
- Regjistrimi i qytetarëve dhe adresave të tyre në ARIS;
- Printimi i formularit të identifikimit të adresave;
- Identifikimi i adresave në terren nëse është e nevojshme;
- Dorëzimi i letrave informuese për adresat në terren për qytetarët;
- Kryerja e kontrollit të cilësisë së të dhënave;

- Mbështetja e komunës në lidhje me procesin e regjistrimit të qytetarëve dhe adresat e tyre;
- Aktivitete të tjera që lidhen me kompletimin e sistemit të adresave.
- Trajnimet përkatëse të konsulentëve do të ofrohen nga AKK.

4. Kushtet e punës

Stafi mbështetës komunal – konsulentët e kontraktuar do të punojnë me orar të plotë në një komunë për një periudhë kohore deri në 12 muaj. Puna kryhet në zyrë dhe në terren. Konsulenti do t'i raportojë Shefit të zyrës vendore të gjendjes civile dhe Drejtorit të drejtorisë për planifikimit urban të komunës përkatëse, i cili gjithashtu do të përgatisë planin e përgjithshëm të punës dhe do të mbikëqyrë punën e përditshme. Komuna është përgjegjëse për sigurimin e hapësirave për zyre, qasjen në kompjuter dhe pajisje të tjera, si dhe transportin e nevojshëm për punën në terren.

5. Përgatitja e nevojshme arsimore dhe përvoja e punës

- Kualifikimet e detyrueshme:
 - Diplomë universitare për studimet e përfunduara (minimumi diplomë Baçelor);
 - Posedimi i patentë shoferit të vlefshëm
- Kualifikimet e preferuara:
 - I/e diplomuar në fushat gjeohapësinore (gjeografi, gjeodezi ose në fusha të tjera të ngjashme);
 - Përvojë pune me të dhëna gjeohapësinore dhe navigim me hartë në terren;
 - Përvojë pune në sistemin e adresave;
 - Përvojë pune në çështje të tjera zyrtare në komuna;
 - Njohuri bazë në teknologjinë e informacionit, preferohet njohuri në sistemet e GIS-it;

Njohuri të çështjeve komunale me prioritet për punë

6. Kriteret e vlerësimit:

- Kualifikimi i përgjithshëm - 30 pikë
- Përvoja specifike në lidhje me detyrën – 70 pikë

7. Procesi i përzgjedhjes

Individët me përvojë dhe të kualifikuar do të përzgjidhen sipas dispozitave të Rregulloreve të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e Financimit të Projekteve Investuese (FPI), të nxjerra në korrik të vitit 2016 dhe të rishikuara në nëntor të viti 2017 dhe gusht të vitit 2018, bazuar në përzgjedhjen e konsulentëve individual përmes një thirrjeje të hapur.

Agjencia Kadastrale e Kosovës është e përkushtuar ndaj parimeve të mundësive të barabarta të punësimit dhe po ashtu është e përkushtuar që të marrë vendime për punësim në bazë të meritave. Jemi të përkushtuar të zbatojmë ligjet e shtetit që ofrojnë mundësi të barabarta punësimi, si dhe të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me kushtet e punësimit. Agjencia dëshiron të mbajë një mjedis pune pa ngacmime seksuale ose pa diskriminime në bazë të racës, fesë, ngjyrës, origjinës kombëtare, orientimit seksual, aftësive të kufizuara fizike dhe mendore, statusit martesor, moshës ose çdo kushti tjetër të mbrojtur nga ligjet e shtetit.